REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 82/22
Date/Datum. 19.04.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili *Ekspert shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit* *06.04.2022*	*Data e dorëzimit të raportit* *19.04.2022*	*Nr. i lëndës:* *82/22*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:31.03.2022, OE ankues **"Arhiko.ing" OP -Prishtinë**, ka parashtruar ankesë me nr: **82/22,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorve ekonomik **"Studio Hapsira" shpk & N.N.P "Bek-Ing"– Prishtinë,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Hartimi i projektit për tri udhëkryqe në qytetin e Prizrenit",*** me nr.të prokurimit: 622-22-828-2-3-6, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Komuna e Prizrenit.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, procedura e kuotimit të çmimit kontratë - shërbim, vlera e ulët, kriteri i dhënjes së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, lloji i procedurës Kuotim i Çmimit, Çmimi më i ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 9 800,00 €

Data e njoftimit për kontratë 16/02/2022, Afati i fundit i dorëzimit të tenderit 23.02.2022, Njoftimi për vendimin e AK-së, 24.03.2022, kërkesa për rishqyrtim 28.03.2022,Vendimi nga ana e AK-se per kërkesën për rishqyrtim 31.03.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, sic janë

Neni 7, 52, dhe 59 të LPP-së, si dhe neni 28.14 i Rroupp.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Ankesa jonë i referohet pikave që kemi kërkuar rishqyrtim nga AK ne lidhje me çmimin me tre numra pas presjes dhjetore.

AK në secilin vendim që bënë për këtë lëndë çdo her i referohet të njëjtit nen, pra nenit 18.3 Rroupp sikur mos te ishin rregullat dhe ligjet e tjera të cilat të ndërlidhura njëra me tjetrën ofrojnë shpjegime më të detajuara në lidhje me çmimet e ofertuar nga OE-të dhe mënyrën e leximit të çmimeve nga ana e AK-së.

Ne jemi skeptik në këto vendime sikur AK nuk do të shoh dhe të marrë parasysh ligje dhe rregulla të tjera, vlen të theksohet edhe fakti që neni 18.3 nuk ofron as edhe një shpjegim në lidhje me çmimet e peshuara pra siç ka kërkuar AK dhe në atë që ai bazohet dhe na shpallë operator të papërgjegjshëm njëherit me po të njëjtin pretendim edhe refuzon ankesën si të pabazuar.

Pika 1. Çmimi i ofertuar nga ana jonë me tre numra pas presjes dhjetore nuk konsiderohet te jetë çmimi bazë që duhet të merret në vlerësimin e ofertës tonë nga ana e AK-së, përderisa çmimi në njësi që kemi ofruar të përshkrimi i shërbimeve në pozicionin Totali me Tvsh është çmimi bazë i ofertës tonë që në Total është në vlere prej 0.65 e që në peshimin e përqindjeve të parapara nga AK del të jetë 0.11

Nga kjo kuptohet që çmimi i peshuar nuk është çmimi që ne kemi ofertuar por është rezultat që ka rrjedhë nga kalkulimi i numrave brenda llogaritjeve dhe ka dalë të jetë me tre numra pas presjes dhjetore!

Edhe neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e tregon se në rastet kur tenderët posedojnë devijime të vogla që në rastin konkret janë ato me çmimet njësi me më shumë shifra pas presjes dhjetore atëherë AK mundet të i pranoj si të mirëqena pasi që nuk shkaktojnë asnjë dëmtim material të AK-së, kuantifikohen lehtë dhe janë shembull i mirë i shfrytëzimit të parasë publike në formën më ekonomike të mundshme.

Ja si i përshkruan neni 59.4 i LPP-së devijimet e vogla/minore:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban

vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Vlenë të theksohet fakti që në bazë të kritereve pagesat nga ana AK-së do të behën sipas çmimit në njësi e jo sipas çmimit të peshuar, këtë e dëshmon edhe neni 28.14 i Rroupp

28.14 Funksioni i vetëm i peshimit te çmimit është qe të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por pagesa gjithmonë kryhet ne baze të çmimit te ofertuar. Çmimi total i poentuar (peshuar)lexohet gjate procesit te hapjes se ofertave.

Gjithashtu AK as ne dosjen e tenderit e as ne paramase nuk ka cekur që çmimi i ofertuar nuk mund të ketë tre numra pas presjes dhjetore, ndërsa të gjithë AK-te një gjë të tille e cekin në paramase kur është për tu ofertuar në kontrata me poentim për punë të ngjashme, ku përderisa një gjë e tille nuk është kërkuar në asnjë pikë në këtë procedure të tenderimit është absurde dhe e pa mbështetur në asnjë rregull qe ne jemi të eliminuar nga kjo procedure tenderimi.

Ku çmimi i ofruar si me tre numra pas presjes dhjetore si me dy numra nuk paraqet ndonjë ndryshim ne buxhet, apo kosto shtese për AK.

Ne kërkojmë nga ana juaj të shqyrtohet dhe merret ankesa për të cilën nuk janë pretendime por fakte që për secilin shqyrtim jemi bazuar në ligjet dhe rregulloret e Krpp-se

Kërkojmë nga ana juaj që të merret:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar Ankesa e paraqitur nga Kompania jone

ANULOHET, vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 24.03.2022 dhe lënda të kthehet në Ri-Vleresim.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

III.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	**Përshtatshmëria profesionale** **Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 3 OE duhet të jetë i**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 3 Qertefikata e TVSH së**

	regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së	
III.3 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar** **3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) ka qen prej jo më pak se 18.000,00 €**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**
III.4 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	**Kapaciteti teknik dhe professional** **Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 12.000,00 € Kërkesa 2 a. Në kuadër të stafit duhet të caktohet menaxheri I projektit I cili duhet të jetë ingjinjer I diplomuar I ndërtimtarisë ose master drejtimi konstruktiv me jo më pak se 5 vite përvojë pune në profesion - Të ketë menaxhuar së paku një projekte të natyrës së kontratës. b. Një ingjinjer i diplomuar ose master i hidros me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion. -c. nje bachelor te gjeodezise te licensuar nga AKK. d. Një ingjinjer i diplomuar ose master i komunikacionit me jo më pak se 3 vite përvojë pune në profesion Kërkesa 3.. Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme adekuat për realizim të kontratës**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Dëshmia 1 Lista e projekteve te ngjashme e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skanuar nga origjinali) për dosjen elektronike, të dëshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e punëve dhe natyrën e tyre apo proces verbal te pranimit përfundimtar të shërbimeve. Dëshmia 2 a. Duhet te caktohet me vendimi menaxheri i projektit, CV-ia, diploma e menaxherit, dëshmi mbi përvojën në punë, dëshmi mbi menaxhimin e projekteve, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. b. d. CV-ia, diploma, dëshmi mbi përvojën në punë, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë c. Diploma, Licenca e lëshuar nga AKK, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. Dëshmi 3 Lista e të punësuarve bashkë me përshkrimin e shkurtër te vendit te punës. Për stafin e rregullt , kontratat e punës të skanuar nga origjinali ose kopjet të noterizuar të kontratave . Për stafin e ri kontratat e bashkëpunimit të skanuar nga origjinali ose kopjet të noterizuar të kontratave për këtë projekt.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 24.03.2022, është konstatuar si në vijim: AK- Komuna e Prizrenit, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik "Studio Hapsira" shpk & N.N.P "Bek-Ing"– Prishtinë, më çmimin e ofruar prej 0,33 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë – furnizim me një operator ekonomik, vlerë e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët me poentim. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër eliminimit të ofertës të OE ankues dhe propozimit të ofertës të OE të rekomanduar për kontratë.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Arhiko.ing" OP -Prishtinë

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 82/22 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, ku sipas AK-së në vendim të kërkesës për rishqyrtim thuhet se :

"*...Ju jeni shpallë i papërgjegjshëm për shkak se në **rekalitulimin** tuaj tek lista e çmimeve keni vendosë më shum se dy shifra pas presjes dhjetore, dhe veprimi i tillë iu kla bërë të papërgjegjshëm...*".

Sipas OE ankues, cmimi me të cilin do të realizoheshin pagesat nuk është me tre numra pas presjes dhjetore.

Pas anlizimit të dosjes së tenderit, pretendimeve ankimore dhe vendimit të AK-së për rishqyrtim, kemi gjetur se OE ankues ka ofruar cmimet si në vijim:

Paramasat per tender: hartimi i projektit për udhëkryqet nga DSHP

Pos	Përshkrimi i shërbimeve/pozicioneve	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi për njësi	Totali me TVSH-€
A	Matjet gjeodezike për të gjitha nevojat e kompletimit të projektit zbatues.	m²	1.00	€ 0.60	€ 0.60
B	**Projekti ideor për udhëkryqet:** Rr. "Ekrem Rexha" dhe "Villiam Valker" te ish Bellona Rr. "Rrustë Kabashi" te semafori i Kforit Rr. Transitore "Kastriotët dhe Transiti" te pompa Arbëria	m²	1.00	€ 0.03	€ 0.03
C	**Projekti Kryesor për udhëkryqet:** Rr. "Ekrem Rexha" dhe "Villiam Valker" te ish Bellona Rr. "Rrustë Kabashi" te semafori i Kforit Rr. Transitore "Kastriotët dhe Transiti" te pompa Arbëria	m²	1.00	€ 0.02	€ 0.02
				TOTALI C:	**€ 0.65**

	R E K A P I T U L I M I		
Pos	**Përshkrimi**	**Çmimi total me TVSH në € i peshuar**	**TOTALI I PESHUAR**
A	**Matjet gjeodezike**	15 % e totalit A	€ 0.090
B	**Hartimi i projektit ideorë**	35 % e totalit B	€ 0.011
C	**Hartimi i projektit kryesor me të gjitha fazat**	50 % e totalit C	€ 0.010
TOTALI	**Çmimi i Total i peshuar (ofertat do te vleresohen ne baze te kesaj vlere). Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes**	**100 %**	€ 0.111

Siq shihet më lart, për të trija pozicionet A, B dhe C, si dhe cmimin total OE ankues (të rrumbullakuara me ngjyrë të kuqe në këtë raport) i ka ofruar me dy shifra pas pikës dhjetore. Këto janë cmime me të cilat do të lidhej dhe do të realizohej kontrata.

Ndërsa te "rekapitluimi", është bërë poentimi i cmimeve në bazë të peshës së caktuar nga AK.

Në rastin konkret vlerësojmë se cmimi i poentuar/peshuar nuk është cmim me të cilin do lidhej apo realizohej kontrata.

Neni 28.14 i RRUOPP-së "**Funksioni i vetëm i peshimit te çmimit** është që të përcaktohet kontrata me çmimin më të ulët, por **pagesa gjithmonë kryhet ne baze të çmimit te ofertuar**. Çmimi total i poentuar (peshuar) lexohet gjate procesit te hapjes se ofertave."

Në bazë të kësaj që ceket si më lart, vlerësojmë se do ishte zbatim i gabuar i dispozitave të RRUOPP-së nëse cmimi i peshuar (i cili nuk jepet nga OE por është rezultat i peshave/përqindjeve të caktuara nga AK për pozicionet konkrete) të përdoret si arsye e eliminimit.

Për më tepër lidhur me procedurat pe poentim/peshim të cmimeve është edhe interpretimi i KRPP-së tek pyetjet e shpreshta, i publikuar në faqe të KRPP-së ku ndër tjera thuhet :

*"...Kurdo që AK ka për qëllim të lidhë një **"kontratë me çmime njësi"**, në përputhje me nenin 56.15 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, në hapje publike të ofertave lexohet çmimi total i poentuar (peshuar) i cili shërben **vetëm për qellim të vlerësimit të ofertave**, ndërsa **"Kontrata lidhet me çmime për njësi"...".***

Më tutje, duke u bazuar në kërkesat që dalin nga neni 7 par.6 të LPP-së :

*Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; ... (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të **gjitha kërkesat për përzgjedhje dhe dhënie**, duke **përfshirë rëndësinë relative të secilës kërkesë dhe kriter të tillë**, si dhe **metodat e përzgjedhjes** dhe dhënies **të saktësohen në njoftimin e kontratës** ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) **që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies***

Ashtu siq ka potencuar OE ankues në ankesën 82/22, AK nuk ka cek në dosje të tenderit se nuk lejohet vendosja e më shumë se tri shifrave pas presjes dhjetore, ndërsa sipas dispozitave të nenit 7 par.6, asnjë kërkesë apo kriter i cilin nuk është saktësuar paraprakisht nuk mund të përdoret në proceisin e përzgjedhjes.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe të obligohet AK- KK Prizren, që lëndën ta kthej në **ri vlerësim**.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Komuna e Prizrenit.
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Arhiko.ing" OP -Prishtinë